



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 3 gusht 2020
Nr. ref.: RK 1594/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI35/20

Parashtrues

Deljalj Kazagić

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës, Pzd. nr. 133/2019, të 18 nëntorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Deljalj Kazagić (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Mitrovicë, i cili ndodhet në vuajtje të dënimit me burg.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, PZD.nr.133/2019 të 18 nëntorit 2019 (në tekstin e mëtejme: Aktvendimi i kontestuar), i cili i është dorëzuar atij më 6 dhjetor 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 21 [Parimet e Përgjithshme], 24.1 [Barazia para Ligjit], 31.2 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 33.4 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Raste Penale], 54 [Mbrotja Gjyqësore e të Drejtave], dhe 55.5 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 24 shkurt 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Selvete Gërxhaliu Krasniqi dhe Bajram Ljatifi (anëtarë).
7. Më 3 mars 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kësaj kërkesë, ne pajtim me Ligjin ia dërgoi Gjykatës Supreme.
8. Më 22 korrik 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës për herë të pestë parashtron kërkesë në Gjykatë.

Faktet në lidhje me kërkesën e parë, KI82/16

10. Më 24 maj 2016, parashtruesi i kërkesës e parashtroi në Gjykatë kërkesën KI82/16, me të cilën kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të

Gjykatës Supreme, Pml.nr.13/2016, të 13 nëntorit 2016, me të cilin pretendonte se i ishin shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimet Mizer, Çnjerëzor ose Poshtërues në rastet Penale], 29 [E drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në raste penale] të Kushtetutës.

11. Më 1 mars 2017, Gjykata nxori Aktvendim për papranueshmëri, me të cilin kërkesa e parashtruesit të kërkesës u deklarua qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, për shkak se i njëjti nuk i kishte mbështetur pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

Faktet përkitazi me kërkesën e dytë, KI50/18

12. Më 30 mars 2018, parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën KI50/2018, përmes së cilën kontestoi kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 110/2017, të 13 nëntorit 2017, me pretendimin se gjykatat e rregullta, duke refuzuar kërkesat e tij për rishikim të procedurës penale, kanë bërë shkelje të nenit 30 [Të drejtat e të akuzuarit], paragrafin 3 të Kushtetutës, *“për shkak të mohimit të së drejtës për të siguruar mbrojtjen e tij dhe mundësisë për t’i kundërshtuar deklaratat e dëshmitarëve dhe provat në ngarkim të tij”*, si dhe shkelje të nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë], paragrafët 1 dhe 2 të Kushtetutës, me pretendimin se *“atij iu pamundësua pjesëmarrja në seancën e Dhomës së Gjykatës së Apelit”*.
13. Më 16 janar 2019, Gjykata nxori Aktvendim për papranueshmëri dhe konstatoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me refuzimin nga gjykatat e rregullta të kërkesës së tij për rishikim të procedurës penale nuk ishin *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, duke qenë se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës, nuk gjenin zbatim në të tilla raste.

Faktet përkitazi me kërkesën e tretë, KI186/18

14. Më 30 mars 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën KI186/2018, me përmes së cilës kontestoi kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pml.nr.168/201, të 3 gushtit 2018, me pretendimin se gjykatat e rregullta, refuzuan kërkesat e tij për rishikim të procedurës penale, në shkelje të nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë] të Kushtetutës, për shkak se atij iu pamundësua pjesëmarrja në seancën e shqyrtimit në Gjykatën e Apelit.
15. Më 8 maj 2019, pasi vlerësoi rrethanat e rastit, Gjykata erdhi në përfundim se neni 6 i Konventës nuk është i aplikueshëm në procedurat për rishikimin e ndonjë rasti penal. Për këtë arsye, Gjykata konstatoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me refuzimin nga gjykatat e rregullta të kërkesës së tij për rishikim të procedurës penale, nuk ishin *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën. Rrjedhimisht, Gjykata konkludoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, në pajtim me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës është e papranueshme.

Faktet përkitazi me kërkesën e katërt, KI96/19

16. Më 12 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën KI96/19, përmes së cilës kontestoi kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pzd.nr.8/2019, të 5 shkurti 2019, me pretendimin se Gjykata Supreme, duke refuzuar kërkesat e tij për rishikimin e procedurës penale, kanë bërë shkelje të nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë] të Kushtetutës, për shkak se nuk i mori parasysh faktet dhe rrethanat lehtësuese për zbutje të dënimit.
17. Më 8 tetor 2019, Gjykata nxori Aktvendim për papranueshmëri dhe erdhi në përfundim se neni 6 i Konventës nuk është i zbatueshme në procedurat për rishikimin e ndonjë rasti penal. Si rrjedhojë Gjykata konstatoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me refuzimin nga gjykatat e rregullta të kërkesës së tij për rishikim të procedurës penale, nuk ishin *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën. Përfundimisht kërkesa e parashtruesit të kërkesës, në pajtim me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores u deklarua e papranueshme.

Faktet përkitazi me kërkesën e tanishme KI35/20

18. Më 5 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës parashtron në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, kundër Aktgjykimi të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.42/2014, të 12 shkurtit 2015, i cili ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PAKR nr.230/15, të 7 shtatorit 2015 dhe ishte ndryshuar vetëm sa i përket pjesës në lidhje me dënimin, duke i shqiptuar parashtruesit të kërkesës një dënim unik me burgim, në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) vjetësh.
19. Më 8 tetor 2019, Gjykata Themelore në Mitrovicë, kërkesën e parashtruesi të kërkesës ia dërgon Gjykatës Supreme për vendimmarrje, me propozimin që kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit të refuzohet. Po ashtu më 23 tetor 2019, Prokurori i Shtetit, i propozoi Gjykatës Supreme që kërkesa e parashtruesit të kërkesës të refuzohet.
20. Më 18 nëntor 2019, Gjykata Supreme me Aktvendimin Pzd.nr.133/2019, refuzoi si të pabazuar kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, me arsyetimin se: *"...Me dispozitën e nenit 429 të KPPK-së, parashikohet se zbutja e dënimit të shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë lejohet kur paraqiten rrethana që nuk kanë ekzistuar në kohën kur është marrë aktgjykimi ose gjykata nuk ka ditur për to, megjithëse kanë ekzistuar, e të cilat qartazi do të qonin në shqiptimin e një dënimi me të butë. (...) Mirëpo, në kërkesë nuk ceken rrethanat të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimeve ose gjykatat për ato nuk kanë ditur, e të cilat do të ndikonin në shqiptimin e dënimit me të butë. Nga sa u tha me lartë, kjo gjykatë gjen se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit dhe konform dispozitës së nenit 431 par.6 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktvendimi."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, me Aktvendimin e kontestuar, shkeli të drejtat e tij të garantuara me nenet 21.4, 24.1, 31.2, 33.4, 54 dhe 55.5 të Kushtetutës.
22. Parashtruesi në përgjithësi ankohet se arsyetimi i Aktvendimit të kontestuar është në kundërshtim të plotë me kërkesën e tij për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, sepse nuk janë marrë seriozisht pretendimet e tij nga Gjykata Supreme. Ai tutje pretendon se moszbatimi i disa dispozitave ligjore të KPPRK dhe KPRK, si nenin 3 [Zbatimi i ligjit më të favorshëm] nga Gjykata Supreme ka shkaktuar shkeljen e të drejtave dhe të lirive të tij të garantuara me Kushtetutë.
23. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon: “ 1. Ta prishë- anulojë Aktvendimin P. zd. nr. 133/2019 të dt. 18.11.2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilin e refuzon si të PABAZË kërkesën time për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit të parashtruar më 05.06.2019 dhe që të njëjtin ta kthejë Gjykatës Supreme të Kosovës për riprocedurë të drejtë për shqyrtim dhe vendimmarrje sipas të njëjtit, për shkak të shkeljes brutale të pretenduara të dispozitës kushtetuese të nenit 33, par. 4 dhe me këtë edhe të drejtat njerëzore dhe liritë e mia të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore. Apo, në kuadër të autorizimeve të saj;
2. Ta ndryshojë Aktgjykimin e plotfuqishëm PAKR nr. 230/15 të Gjykatës së Apelit të Kosovës të dt. 07.09.2015 me të cilin më ka dënuar për katër (4) vepra penale me gjithsej – dënim i përgjithshëm ($12 = 4 + 2 + 2 + 4$) 12 vjet burgim. Gjegjesisht me dënim unik prej njëmbëdhjetë (11) vjetëve. Ashtu që për veprën penale të parë: Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet (në kundërshtim me nenin 198. 1 të KPK) për çka jam dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm me katër (4) vjet burgim, sipas bazë ligjore të Kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit dhe sipas dispozitës kushtetuese të nenin – 33, par. 4, të anulohet – priset ky dënim me burg prej katër (4) vjetëve dhe të zbutet dënimi i përgjithshëm nga 12 vjet në tetë ($8 = 0 + 2 + 2 + 4 = 12 - 4$) vjet burgim, gjegjesisht të zbutet dënimi unik nga 11 vjet në 7 vjet, eventualisht në shtatë vjet e gjysmë (7 eventualisht 7,5) vjet burgim.”

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1.Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë,

mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
[...]

26. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

27. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme Pzd.nr.133/2019, 18 nëntor 2019, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në afatin e përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

28. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur gjithashtu kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, përkatësisht me paragrafët (2) dhe (3) (b) të rregullit 39 të Rregullores, që përcaktojnë:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]”

(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;

[...]"

29. Gjykata, fillimisht qartëson se nuk do të shqyrtoj pretendimet e parashtruesit të kërkesës të cilat ishin objekt i vlerësimit nga Gjykata, në rastet KI82/16, KI50/18, KI186/18 dhe KI96/19. Në rastin konkret, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të kontestuar Pzd.nr.133/2019 të Gjykatës Supreme, të 18 nëntorit 2019, më të cilin pretendohet shkelja e të drejtave të tij të garantuara me nenet: 21, 24.1, 31.2, 33.4, 54 dhe 55.5 të Kushtetutës.
30. Gjykata verën se esenca e pretendimeve të parashtruesit të kërkesë ndërlidhet me mënyrën e arsyetimit të Aktvendimit të kontestuar nga Gjykata Supreme, duke mëtuar se arsyetimi i dhënë nga e njëjta është në kundërshtim të plotë me kërkesën e tij për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, sepse nuk janë marrë seriozisht pretendimet dhe dëshmitë e tij. Pjesa tjetër e pretendimeve ka të bëjë me mënyrën e zbatimit të dispozitave të ligjit procedural dhe material përkatësisht të KPPRK-së dhe KPRK-së.
31. Në këtë kontekst dhe në vijim, Gjykata do t'i trajtojë pretendimet e parashtrueses së kërkesë lidhur me: i. shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës dhe ii. shkeljet e pretenduara të neneve 21, 24.1, 33.4, 54 dhe 55.5 të Kushtetutës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
- i. *Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, ne lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së*
32. Gjykata së pari rikujton se e drejta e kërkuar nga parashtruesit e kërkesave, para së gjithash duhet të jetë e mbrojtur dhe e garantuar me Kushtetutë dhe KEDNj. Andaj, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata do të vlerësojë nëse e drejta e kërkuar nga parashtruesi i kërkesës mbrohet më Kushtetutë dhe KEDNj, gjegjësisht nëse neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj, janë të zbatueshëm në rastin e tij.
33. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar "kërkesë për zbutje të jashtëzakonshëm të dënimit" në Gjykatën Supreme, nëpërmjet Gjykatës Themelore, bazuar në KPPRK. Në rrethanat e këtij rasti, Gjykata verën se Gjykata Supreme vlerësoi vetëm aspektet procedurale të lejueshmërisë së kërkesës se parashtruesit të kërkesës, pa e prekur substancën e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovice P.nr.42/2014, të 12 shkurtit 2015 i cili ishte bërë i plotfuqishëm me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 220/2015 të 7 shtatorit 2015.
34. Në këtë kuptim, Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), rikujton se neni 6 i Konventës nuk është i zbatueshëm në procedurat për rishikimin e ndonjë rasti penal, nëse një person dënim i të cilit është bërë i plotfuqishëm

dhe i cili bën kërkesë për rishikimin e rastit të tij dhe ai ose ajo gjatë kësaj procedure nuk është “akuzuar për ndonjë vepër penale” brenda kuptimit të nenit 6 të Konventës (shih rastet e GJEDNJ-së *Franz Fischer kundër Austrisë*, ankesa nr. 27569/02, vendimi, i 6 majit 2003).

35. Në rastin konkret, kërkesa e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, ushtruar në Gjykatën Supreme, në fakt ka kërkuar rihapjen e procedurave të përfunduara me vendim të plotfuqishëm, sa i përket vendimit për dënimin. Megjithatë, siç mund të vërehet nga arsyetimi i Gjykatës Supreme, kërkesa e parashtruesit të kërkesës ishte refuzuar, sepse e njëjta nuk i përmbushte kushtet ligjore për rihapjen e Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Mitrovice P.nr.42/2014, të 12 shkurtit 2015, sa i përket vendimit për shpëtimin e dënimit.
36. Ne këtë vazhde, Gjykata, rikujton praktiken e GjEDNJ-së, e cila përcakton: “...se neni 6 i KEDNJ-së, nuk gjen zbatim, përderisa autoritet vendore nuk pranojnë të rihapin një procedurë, madje edhe në ato raste ku parashtruesi kishte paraqitur kërkesën për rihapje të procedurës në sajë të një aktgjykimi të mëparshëm të Gjykatës me të cilin është vërtetuar se ka pasur shkelje të Konventës në lidhje me procedurën e kontestuar para gjykatave vendore (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Franz Fischer kundër Austrisë*, kërkesa nr. 37950/97, të 29 majit 2001). Megjithatë, në atë moment kur procedura rihapet ose kur aprovohet rishikimi i jashtëzakonshëm i procedurës, mekanizmat mbrojtës nga neni 6 i KEDNJ-së zbatohen për tërë procedurën gjyqësore (shih Vendimin e GJEDNJ-së *Vanyan kundër Rusisë*, kërkesa 53203/99, të 15 dhjetorit 2005, par. 56–58).
37. Për më tepër, Gjykata rikujton se mjetet juridike të jashtëzakonshme me të cilat kërkohet zbutje e jashtëzakonshme e dënimit zakonisht nuk implikojnë vërtetimin e “të drejtave dhe obligimeve civile” apo bazueshmërinë e “çfarëdo akuze penale”, dhe rrjedhimisht neni 6 nuk zbatohet për ta (shih, inter alia, *X kundër Austrisë*, numër 7761/77, Vendimi i Komisionit i 8 majit 1978, *Hurter kundër Zvicrës*, vendimi numër 48111/07 i 15 majit 2012, *Dybeku kundër Shqipërisë*, vendimi numër 557/12, paragrafi 30, i 11 marsit 2014).
38. Në këtë sfond, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se me Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme [APP-UPP.nr.1/2018], të 26 shkurtit 2019, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së nuk janë *ratione materia* në pajtim me Kushtetutën.
- ii. Sa i përket pretendimeve tjera për shkelje të neneve 21.4, 24.1, 33.4, 54 dhe 55.5 të Kushtetutës
39. Për më tepër, Gjykata verën se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar po ashtu shkel të drejtat e tij të garantuara me nenet 21.4, 24.1, 33.4, 54 dhe 55.5 të Kushtetutës. Ne rastin konkret parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend nenet respektive, pa elaboruar tutje se si dhe pse ka ardhur deri të shkelja e tyre me Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje

kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Kushtetuese KI136/14, parashtrues: *Abdullah Bajqinca*, Aktvendimi për papranueshmëri, paragrafi 33; KI187/18 dhe KI 11/19, parashtrues: *Muhamet Idrizi* Aktvendimi për papranueshmëri i 29 korrikut 2019, paragrafi 73, dhe se fundmi rastin KI125/19 parashtrues: *Ismajl Bajgora*, Aktvendimi për papranueshmëri i 11 marsit 2020, paragrafi 63).

40. Andaj, në lidhje me këto pretendime, Gjykata ne përputhje me praktiken e saj kërkesën e parashtrueses së kërkesës e deklaron qartazi të pabazuar dhe rrjedhimisht të papranueshme.

Përfundim

41. Gjykata, bazuar nga si me sipër, konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës:
- i. përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetues, nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën;
 - iii. përkitazi me pretendimet për shkelje të neneve 21.4, 24.1, 33.4, 54 dhe 55.5 të Kushtetutës, në baza kushtetuese, duhet deklaruar gjithashtu e papranueshme si qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores se Punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) dhe (3) (b), si dhe rregullin 59 (2) të Rregullores, në seancën e mbajtur më 22 korrik 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Laban Radomir

Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi